

<p align="center">Si eshte propozuar ne projektligjin:</p> <p align="center">PËR VETËQEVERISJEN VENDORE</p>	<p align="center">Çfare propozon INFOÇIP</p>
<p>Neni 7 Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore 1. Në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. 2. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. 3. Organ përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funkcionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut. 4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. 5. Organi përfaqësues i qarkut krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në kreun XIII të këtij ligji. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut, sipas mënyrës së përcaktuar në kreun XIII, të këtij ligji.</p>	<p>Nga pikepamja teknike, edhe kryetari i bashkisë edhe anëtarët e këshillit janë njësoj produkt i votës në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore. Rrjedhimisht këto janë që të dyja institucione me përfaqësim. Për këtë arsye rekomandohet që termi të jetë:</p> <p align="center">ORGANI VENDIMARRES (në vend të organi përfaqësues)</p> <p>Mbi të njëjtën llogjike, sugjerohet ndryshimi i terminologjisë në projektligj për nivelin e dytë të qeverisjes vendore, Qarkun.</p>
<p>Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë B. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</p>	<p>Rekomandohet heqja nga projektligji i të drejtës së bashkive për të shitur pronë. Disa nga arsyet janë sa më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Problem i ndarjes së provave pronarëve legjitimë akoma nuk ka përfunduar në shqipëri dhe futja me ligj e një organizate publike në transaksione të shitjes së pronës do ta komplikonte më keq problemin. 2. Legjislacioni për shtiblerjene pronës është akoma i paplotësuar. 3. Inventarizimi i pronës që ka kaluar në administrim abshkive

<p>b) E drejta e fitimit të pronës nëpërmjet shpronësimeve për interes publik nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p> <p>c) E drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.</p>	<p>është i pakompletuar, sidomos në nivel të Njësive Administrative (ish-komunave).</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Nuk ka një databazë të besueshme hipotekore që do ta adresonte jashtë sferes konfliktuale procesin e shitjes së prnës. 5. Ka një shqetësim të dokumentuar për korrupsion masiv në shpërndarjen e titujve të pronësisë, sidomos në nivel të qeverisjes vendore. 6. Një organizatë publike nuk mund të gëzojë dhe as të vishet më të drejta korporative (tipike të sferës së të drejtës private).
<p>Neni 13 Mbikëqyrja dhe kontrolli</p> <p>1. Me qëllim garantimin e zbatimit të normave e të standardeve kombëtare të përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe në përputhje me parimin e autonomisë vendore, ministrinë sipas fushave të përcaktuara të përgjegjësisë, kanë të drejtë të mbikëqyrin dhe të monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore për funksionet e deleguara.</p> <p>2. Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.</p> <p>3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen kontrollit të jashtëm financiar nga organet e qeverisjes qendrore për përdorimin e fondeve të kushtëzuara dhe/ose të deleguara që financohen nga buxheti i shtetit dhe/ose fondet e ndihmës së huaj, të alokuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja qendrore.</p> <p>5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>Sugjerohet që pika 2 e nenit 13 të riformulohet si më poshtë:</p> <p>Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.</p> <p>Pra, termi “me karakter normativ” të eliminohet nga trupi i kësaj dispozite. Shumica e akteve në nivel vendor nuk janë me karakter normativ, por me karakter individual. Të tilla janë psh vendimet për ndihmën e ekonomike, për strehimin social, për bordet e ndërmarrjeve, për titujt e nderit, për koncensionet, për kontratat e qerave (në përgjithësi i gjithë legjislacioni vendor për tjetërsimin e pronës ka natyrë individuale). Duke lejuar kontrollin vetëm mbi aktet normative, rreth 805 e gjithë prodhimtarisë vendiamrreë nuk i nënshtrohet kontrollit institucional.</p> <p>Hartuesit e këtij projektligji kanë bërë një përpjekje për të eliminuar dallimin midis akteve normative dhe atyre individuale, të cilat akviziojnë protokolle të ndryshme në votim dhe në shpallje. Në këtë rast, sugjerimi I INFOCIP, pra eliminimin e frazës “me karakter normativ” synon të konsolidojë këtë linjë të ndjekur nga hartuesit e këtij projek-ligji.</p>
<p>Neni 17</p>	<p>Te abrogohet pika 3 e nenit 17, pasi bie ndesh me parimet e qeverisjes</p>

<p>Mbledhjet e hapura të këshillit të bashkisë</p> <p>1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.</p> <p>2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.</p> <p>3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura kur për këtë ka votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij</p>	<p>se mire dhe te hapur te snksionuara ne dokumentat e KiE dhe te ratifikuar nga Shqiperia</p> <p>Abrogimi i kësaj dispozite (prezente edhe në ligjin aktual 8652 të ndryshuar) është një rekomandim i kahershëm i Qendrës për Çështje të Informimit Publik.</p> <p>Kjo dispozite ne projektligj bie ndesh ne frume por edhe ne germe me percaktimet e nenit 23/3 te Kushtetutes se Shqiperise, si me poshte: Neni 23</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.
<p>Neni 33 Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike</p> <p>1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) njësive organizative të veta që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore; b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi; c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta; ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi; d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi. 	<p>Ne jemi per abrogimin e germave: c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta; ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>Duke vlerësuar ecurinë e deritanishme të efektivitetit publik të kësaj forme, adlim në konkluzionin që partneriteti publik-privat është një format i cili dëmton interesin publik në favor të pasurimit privat-korporativ, shtrembëron llogaridhënien publike të të zgjedhurve vendore dhe kompromenton linjën e përfaqësimit publik vertikal, duke shmangur përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve prej atyre që votebesohen nga qytetarët.</p> <p>Per me teper, ne situaten e re qe ka krijuar RAT, bashkite e reja te krijuar jane ne pozita te favorshme per me shume siper marrje publike, pasi pritet te sigurojne me shume te ardhura.</p> <p>Se fundmi, nga vleresimet rezulton qe borxhi me imadh i akumuluar per</p>

	<p>NJQV deri me sot janë detyrimet e papaguar ndaj të trteteve. Pa u rregulluar me pare kjo situatë, nuk duhet të lejohet përdorimi i formateve konkensionare në shërbime për bashkite.</p> <p>Se fundmi, konkensionimi I shërbimeve, nuk sjell asnjë vlerë të shtuara, sikurse do të ishte fjala vjen konkensionimi i forms “BOT” .</p>
<p>Neni 50 Betimi</p> <p>1. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit: <i>“Betohe, në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të mbroj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e saj. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (emri i bashkisë përkatëse) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.”</i></p> <p>2. Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.</p>	<p>Sugjerohet heqja e fjalës “mbroj” (Kushtetutën...). Misioni i mbrojtjes së kushtetutës dhe garantimit të regjimit juridik që ajo dikton, është misioni i gjykatës Kushtetuese. Të zgjedhurit vendor duhet të respektojnë kushtetutën dhe ligjet në fuqi në RSH. Në thelb është mos-respektimi i kushtetutës dhe i ligjit (dhe jo mos-mbrojtja e tyre) që aktivizon mekanizmin e përgjegjshmerisë para ligjit, apo edhe të shkeljes se vete betimit të dhënë në marrjen e mandatit. Propozohet adoptimi i kësaj formule.</p> <p><i>“Betohe, në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e vendit tim. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të mbroj interesin më të lartë të publikut para interesave partiakë, personalë apo privatë. Betohe se, si kryetar i bashkisë (emri i bashkisë përkatëse) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.”</i></p>
<p>Neni 51 Të drejtat e këshilltarit</p> <p>1. Këshilltari kryen funksionin pa shpërblim. Ai ka të drejtë të rimbursohet për shpenzime udhëtimi për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit sipas legjislationit në fuqi.</p> <p>2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.</p>	<p>INFOCIP i sugjeron Kuvendit rishikimin e pikes 1 të nenit 51 duke e abroguar fjalë të pare, për të garantuar shpërblimin për këshilltarët.</p> <p>Nese vertet synohet një këshill me funksione të përmirësuar kontrolli ndaj administratës, kërkohet minimalisht profesionalizem dhe përkushtim, dhe baza e profesionalizimit është një pagesë fikse e garantuar, njësoj si edhe deputetët e Kuvendit. Pagesa është themeli i profesionalizimit</p> <p>Për më tepër, në kontekstin e RAT, këshilltarët duhet të udhetojnë edhe në/nga zonat rurale, duke prodhuar në cdo rast kosto oportune të</p>

<p>3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë nga kryetari i bashkisë përkatëse çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.</p> <p>4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.</p>	<p>angazhimit të tyre.</p> <p>Pagesa aktuale që ata përftojnë, është në thelb një “rumbullakesim” i këtyre shpenzimeve.</p> <p>Se fundmi, solemniteti i këshillit duhet garantuar edhe duke mos detyruar këshilltarët të plotësojnë formulare në zyrën e financës për diçka udhëtimi.</p>
<p>Neni 55 Votimi</p> <p>1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.</p> <p>2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.</p> <p>3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.</p> <p>4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.</p> <p>5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më të madh të votave dhe nëse votat janë të barabarta fituesi caktohet me short.</p> <p>6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Pika gjashtë sugjerohet të jetë vetëm me një fjali:</p> <p>6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.</p> <p>Pjesa e dytë e dispozitës të abrogohet: Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to</p> <p>Arsyet: projektligji ka eliminuar ë përgjithësi dallimin midis akteve normative dhe akteve individuale. Është në pikën 1 të nenit 55, ky dallim është eliminuar (në ligjin aktual 8652 të ndryshuar ekziston).</p> <p>Rekomandohet që, për shkak të juridiksioneve të zgjeruara që kanë bashkitë e reja në kuadër të RAT, njoftimi fizik i subjekteve të zëvendëshet me prurimin e njoftimit.</p> <p>Po ashtu, sa kohë si mënyrë kryesore e njoftimit/publikimit të akteve është botimi elektronik i tyre, ka mundësi reale për të gjithë subjektet që adresohen nga vendimet e këshillit që ato të marrin njoftim në mënyrë proactive.</p> <p>Po ashtu, njoftimi proaktiv është edhe metoda që është adoptuar në kuadër të ligjit “Për qendrën e Botimeve zyrtare, ligjit “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare”</p>

<p>dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to</p>	
<p>Neni 59 Kryetari i bashkisë</p> <p>1. Çdo bashki ka kryetarin e saj të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.</p> <p>2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p>3. Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë.</p> <p>4. Zëvendëskryetari i bashkisë nuk mund të jetë anëtar i këshillit bashkiak.</p>	<p>Rekomandohet që pika 2 e nenit 59 të jetë:</p> <p>2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 2 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë.</p> <p>Kufizimi i mandateve është një kërkesë konstante e ardhur prej kohësh tashme nga shoqëria civile. Kufizimi i mandateve në vetëm 2 të tilla ka qenë një nga risitë që ka patur projekti-ligji në versionin e tij origjinal. Në fazën e konsultimeve për draftimin e tij, neni 59 u prezantuar nga hartuesit e projektligjit si një prej risive kryesore. Ai u mbështet nga të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile që u konsultuan.</p> <p>Analogjia me legjislacionin Italian nuk qëndron, pasi ka një diferencë prej se paku dy vitesh në kumulativ. Nderkohe, analogjia nuk qëndron pasi në Itali mund të ushtrohen de-facto dy mandate, dhe jo tre, sikurse është modifikuar nga autorët.</p> <p>Në relacionin shpjegues të projektligjit motivohet si nevojë e diktuar edhe nga korrupsioni që ka bashkeshoqeruar si fenomen qeverisjen e deritanishme vendore në Shqipëri. Nëq nga premisat favorizuese të korrupsionit është edhe qëndrimi i gjatë në pushtet i funksionarëve publikë. Nëse autorët që kanë sjelle për miratim në kuvend këtë draft kanë shqetësim të vertetë për korrupsionin, atëherë punë duhet filluar nga kufizimi i mandateve në vetëm dy, madje pa të drejtë rizgjedhjeje. Shembulli i SHBA është rati më i mirë në këtë rast, ku edhe në vendim me dekokratik të botes, vetë presidenti ka të drejtë të rizgjidhet vetëm dy here.</p>
<p>Neni 61 Përfundimi para kohe i mandatit të kryetarit të bashkisë</p> <p>1. Mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur</p>	<p>Të shtohet një gërme më shumë, gërma “ë” në listën shteruese të nenit 1:</p> <p>ë) zgjidhet kryetar i një partie parlamentare gjatë kohës kur ushtron mandatin e</p>

<p>kryetari:</p> <ul style="list-style-type: none">a) nuk pranon të bëjë betimin;b) jep dorëheqjen;c) nuk është më banor i përhershëm i bashkisë, ku është zgjedhur;ç) shkarkohet sipas nenit 62, të këtij ligji;d) kandidon për deputet;dh) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;e) vdes. <p>.....</p>	<p>kryetarit te bashkise.</p> <p>Përvoja e afërt ka demonstruar se dy kryetarët e fundit të bashkisë më të madhe në vend, Tiranës, kanë marrë përsipër të drejtojnë partitë politike kryesore në vend, respektivisht PS dhe PD. Kjo zgjedhje e krybashkiave të Tiranës ka kompromentuar performimin e funksioneve në interes të të gjithë qytetarëve si dhe ka cënuar vijueshmërinë e financimeve qeveritare për bashkinë e kryeqyteti nga qeveria qendrore (për arsye politike).</p>
---	--